

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-26-675-5-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Rehabilitimi i instalimit të ndriçimit dhe prizave elektrike në stacionin e mazutit dhe punëtorinë mekanike – Lot 2**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

OE “BAK - ING SH.P.K.”

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. “Hakif Zejnullahu”, Ulpianë

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

+383 44603866

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Baki Shala

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

baking.ks@gmail.com

(Adresa elektronike)

15.06.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: **Rehabilitimi i instalimit të ndriçimit dhe prizave elektrike në stacionin e mazutit dhe punëtorinë mekanike.**

Njoftimi për kontratë është bërë në datën 13.03.2026 ndërsa hapja publike është bërë në datën 14.04.2026.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së përmes formularit B58 është bërë në datën 20.05.2026.

Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohorë me datë 25.05.2026 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datën 03.06.2026 ka publikuar vendimin e shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të cilën e ka refuzuar, andaj të pakënaqur me këtë refuzim po i drejtohem OSHP-së me ankesë.

Kriteri i dhënies ka qenë: **Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Hapja e tenderëve është bërë në datën 14.04.2026. Në procesverbalin e hapjes së tenderëve nuk ishte evidentuar ndonjë vërejtje apo shkelje ligjore.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Njoftimi për kontratë është bërë në datën 13.03.2026 ndërsa hapja publike është bërë në datën 14.04.2026.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së përmes formularit B58 është bërë në datën 20.05.2026.

Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohorë me datë 25.05.2026 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datën 03.06.2026 ka publikuar vendimin e shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të cilën e ka refuzuar, andaj të pakënaqur me këtë refuzim po i drejtohem OSHP-së me ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit

për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së,
AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së,
AK ka shkelur nenin 19 të RRPP-001/2022,,
AK ka shkelur nenin 57 të LPP-së,
AK ka shkelur nenin 28 të RRPP-001/2022,
AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së,
AK ka shkelur nenin 40 të RRPP-001/2022,
AK ka shkelur nenin 44 të RRPP-001/2022,
AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së,

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve për Lot 2 nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit si të barabartë por përkundrazi e ka favorizuar dukshëm OE që më pas e ka shpallur fitues. Kjo ka ardhur si pasojë e asaj kur OE të shpallur fitues AK e ka konsideruar të përgjegjshëm edhe pse ka shumë mangësi në tenderin e tij. Nga arsyetimi për rezultatin e vlerësimit që ka dërguar AK dhe pas krahasimit të tij me tenderin e OE të shpallur fitues, shihet se gjendja në tenderin e OE të shpallur fitues është e pa pranueshme sa i përket plotësimit të kriterëve të kërkuara në dosjen e tenderit. Përpos kësaj, ky OE ka edhe gabime administrative në plotësimin e drejtë të dosjes së tenderit të cilat sipas ligjit e bëjnë tenderues plotësisht të papërgjegjshëm. Këtu po shihet qartë se AK nuk ka aplikuar si duhet kërkesat e dosjes së tenderit kur ishte në pyetje tenderi i OE Power Engineering SHPK dhe nuk e ka zbatuar si duhet as nenin 28, 57, 59 dhe 69 të LPP-së si dhe nenin 19, 28, 40 dhe 44 të RRPP-001/2022. Zbatimi i drejtë i kërkesave nga dosja e tenderit dhe zbatimi i drejtë edhe i dispozitave ligjore të cekura më lartë, do të rezultonte në eliminimin e këtij tenderuesi dhe në shpalljen si fitues të tenderit tonë.

Sipas asaj që është në nenin 7 të LPP-së, vlerësimi i AK-së konsiderohet të jetë subjektiv pasi që në vetë përbën trajtim jo të barabartë të tenderuesve përkatësisht favorizim të hapur të OE që e ka shpallur fitues e që njëherë konsiderohet shkelje e pastër e kësaj dispozite ligjore. Më detalisht për secilin gabim të AK-së që ka bërë gjatë këtij procesi të vlerësimit si dhe për çdo mangësi të OE të shpallur fitues, do ju njohim në pretendimet në vazhdim.

2. AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së dhe 19 të RRPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderit që e ka shpallur fitues në Lot 2, nuk i ka respektuar si duhet specifikimet teknike që vet i ka

paraparë në Aneksin 1 të dosjes së tenderit. Përpos që katalogjet nuk janë të lexueshme, shihet qartë se për disa pozicione, OE i shpallur fitues nuk ka ofruar fare të dhëna teknike ndërsa në disa të tjera ato nuk përputhen me kërkesat e dosjes së tenderit. Ja si e parasheh këtë detyrim ligjor rregullorja RRPP-001/2022 për OE por edhe për AK:

19.11 Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm.

Përpos kësaj, disa nga katalogjet janë komplet të palexueshëm andaj kjo konsiderohet mangësi që OE e bënë të papërgjegjshëm. Ja si duket një pjesë e katalogjeve të tilla:

MTS06 SERISI TEKNİK BİLGİLER TECHNICAL INFORMATION							
NÖD CODE	KUTUP SAYISI NO OF POLES	AÇIKLAMA DESCRIPTION	KUTU BOX	KOLİ PARÇEL	KUTU AĞIRLIK WEIGHT kg	KUTU HACİM VOLUME m3	
MTS06-1001B	1P	GKA 1P 1A, 0 TİPİ OTOMATİK SİGORTA, 0 TYPE MINIATURE CIRCUIT BRK KBR (MCB)	12	240	1,964	0,001846084	
MTS06-1002B	1P	GKA 1P 2A, 0 TİPİ OTOMATİK SİGORTA, 0 TYPE MINIATURE CIRCUIT BRK KBR (MCB)	12	240	1,96196	0,001846084	
MTS06-1003B	1P	GKA 1P 2A, 0 TİPİ OTOMATİK SİGORTA, 0 TYPE MINIATURE CIRCUIT BRK KBR (MCB)	12	240	1,96196	0,001846084	
MTS06-1004B	1P	GKA 1P 4A, 0 TİPİ OTOMATİK SİGORTA, 0 TYPE MINIATURE CIRCUIT BREAKER (MCB)	12	240	1,97996	0,001846084	
MTS06-1005B	1P	GKA 1P 6A, 0 TİPİ OTOMATİK SİGORTA, 0 TYPE MINIATURE CIRCUIT BRK KBR (MCB)	12	240	1,22796	0,001846084	
MTS06-1006B	1P	GKA 1P 6A, 0 TİPİ OTOMATİK SİGORTA, 0 TYPE MINIATURE CIRCUIT BRK KBR (MCB)	12	240	1,076	0,001846084	
MTS06-1010B	1P	GKA 1P 10A, 0 TİPİ OTOMATİK SİGORTA, 0 TYPE MINIATURE CIRCUIT BREAKER (MCB)	12	240	1,076	0,001846084	
MTS06-1016B	1P	GKA 1P 16A, 0 TİPİ OTOMATİK SİGORTA, 0 TYPE MINIATURE CIRCUIT BRK KBR (MCB)	12	240	1,076	0,001846084	
MTS06-1020B	1P	GKA 1P 20A, 0 TİPİ OTOMATİK SİGORTA, 0 TYPE MINIATURE CIRCUIT BRK KBR (MCB)	12	240	1,188	0,001846084	
MTS06-1025B	1P	GKA 1P 25A, 0 TİPİ OTOMATİK SİGORTA, 0 TYPE MINIATURE CIRCUIT BREAKER (MCB)	12	240	1,188	0,001846084	
MTS06-1032B	1P	GKA 1P 32A, 0 TİPİ OTOMATİK SİGORTA, 0 TYPE MINIATURE CIRCUIT BREAKER (MCB)	12	240	1,2	0,001846084	
MTS06-1040B	1P	GKA 1P 40A, 0 TİPİ OTOMATİK SİGORTA, 0 TYPE MINIATURE CIRCUIT BREAKER (MCB)	12	240	1,188	0,001846084	
MTS06-1050B	1P	GKA 1P 50A, 0 TİPİ OTOMATİK SİGORTA, 0 TYPE MINIATURE CIRCUIT BRK KBR (MCB)	12	240	1,188	0,001846084	
MTS06-1063B	1P	GKA 1P 63A, 0 TİPİ OTOMATİK SİGORTA, 0 TYPE MINIATURE CIRCUIT BREAKER (MCB)	12	240	1,188	0,001846084	

Përpos krejt këtyre, OE në fjalë ka mangësi të theksuara edhe në prezantimin e të gjitha pozicioneve ashtu siç ishin kërkuar. Vlen të thuhet edhe kjo se asnjë produkt nuk është nënvizuar në katalog edhe përkundër që kjo ishte kërkesë decitive e dosjes së tenderit. Në vazhdim po tregojmë se ku janë disa nga mangësitë tek specifikimi teknik i disa artikujve sipas pozicioneve:

Poz. 22 – s'ka fare të dhëna për **3P+E, 63A** – e që e bënë artikullin të papranueshëm!

Poz. 24 – Katalogu është komplet i palexueshëm që gjithashtu e bënë artikullin të papranueshëm!

Poz. 25. – Mungojnë dimensionet, mungon IP55 dhe mungojnë Standardet (shih katalogun faqe 79) - e që e bënë artikullin të papranueshëm!

Poz. 29 – Është kërkuar me 2 poça LED, është ofruar me çip LED, - këtu kemi të bëjmë me ndryshim specifikimi e që e bënë artikullin të papranueshëm!

Poz. 32 – Mungojnë të dhënat e kërkuara - e që e bënë artikullin të papranueshëm!

Poz. 33 – Mungojnë dimensionet e kërkuara – e që e bënë artikullin të papranueshëm!



Poz. 35

Është kërkuar!	Është ofruar!
85-265V	100-277V
120000h	50000h
5040Lm	4500Lm

Përpos këtyre specifikimeve që i cekëm më sipër, ka edhe shumë pozicione ku specifikimet e kërkuara nga AK nuk janë plotësuar në masën e duhur për çka e ftojmë ekspertin që të bëjë verifikim detal të secilit pozicion. Mos plotësimi i specifikimeve teknike, tenderuesin në fjalë e bënë tërësisht të papërgjegjshëm, ndërsa AK-në e bënë shkelëse të plotë të kritereve që vet i ka përcaktuar tek aneksi 1 dhe shkelëse të nenit 28 të LPP-së si dhe 19 të RRPP-001/2022.

3. AK ka shkelur nenin 57 të LPP-së dhe nenin 28 të RRPP-001/2022 kur gjatë vlerësimit të tenderëve, e ka pranuar si të rregullt sigurimin e tenderit të këtij OE. Këtë e themi për faktin se OE Power Engineering SHPK, nuk ka dorëzuar sigurimin e tenderit veç e veç për secilin Lot, por e ka dorëzuar një sigurim të përbashkët për të dy lotët. Bazuar në interpretimet e KRPP-së dhe në praktikat e aplikuara nga vet OSHP në shumë vendime paraprake, në rastet e tilla tenderuesi që nuk dorëzon sigurimet e tenderit si dokument të ndarë për lot-et përkatëse, konsiderohet tenderues i papërgjegjshëm. Ja si duket kërkesa e AK-së dhe ja si duket edhe sigurimi i tenderit që ky OE ka paraqitur në tenderin e tij:

Siguria e tenderit	13.1	A është e nevojshme siguria e tenderit: Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
	13.2	Vlera e sigurisë së tenderit 2000 Euro LOT1 1000 Euro LOT2 1000 Euro Vlefshmëria e sigurisë së tenderit ne ditë 120

	SIGURIM TENDERI	
<p>Polica nr. : 10001328181</p> <p>Për : KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a. (në vazhdim: "autoriteti kontraktues")</p> <p>Në emër të : Power Engineering SH.P.K. (në vazhdim: "tenderuesi")</p> <p>Titulli i aktivitetit të prokurimit : Rehabilitimi i instalimit të ndriçimit dhe prizave elektrike në stacionin e mazutit dhe punëtorinë mekanike Lot 1 dhe Lot 2</p> <p>Numri i Prokurimit :KEK-26-675-5-2-1</p> <p style="text-align: center;">Garancion me kërkesë të parë</p> <p>DERISA tenderuesi ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri tenderi duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit te lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;</p> <p>DHE NGASE tenderuesi dëshiron të depozitojë garancinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;</p> <p>DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci:</p> <p>ANDAJ NE, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të tenderuesit, deri në një total prej: 2,000.00 € (Dy Mije e Euro) zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesen tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërbushja e njërit nga kushtet në vijim:</p>		

Pra forma e tillë e sigurimit është e papranueshme sipas ligjit dhe praktikave të kaluara në OSHP ndërsa verimi i AK-së për pranim të tijë si dokument të rregullt bie ndesh plotësisht me nenin 28 të RRPP-së, bie ndesh me 57 të LPP-së si dhe bie ndesh edhe me interpretimin e KRPP-së dhe kërkesën e vendosur nga vet AK në dosjen e tenderit. Tenderuesi në fjalë realisht do duhej cilësuar i papërgjegjshëm.

4. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit nuk i ka respektuar kërkesat e veta nga dosja e tenderit ashtu siç e parasheh neni në fjalë duke mos bërë vlerësim, sqarim dhe krahasim të drejt të tenderuesve.

Neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e përcakton se:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

E themi këtë sepse shihet qartë se AK e ka pranuar si të rregullt tenderin e OE që e ka shpallur fitues tek Lot 2 edhe pse i njëjti posedon mangësi të theksuara dhe shumë domethënëse në tenderin e tijë.

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së dhe nuk i ka respektuar as kërkesat e veta kur e ka shpallur si fitues tenderuesin Power Engineering SHPK pasi që tenderi i tijë posedon mangësi shumë të theksuara. Mangësitë po i renditim në vazhdim për të cilat do paraqesim edhe argumente dhe dëshmi.

Mangësia 1; - OE Power Engineering SHPK nuk e ka plotësuar si duhet specifikimin teknik të kërkesave që ndodheshin tek Aneksi 1. Për këtë pretendim kemi dhënë argumentet dhe dëshmitë më sipër tek argumentimi i shkëljes së nenit 28 të LPP-së dhe 19 të RRPP-së. Shihe argumentimin e tillë në pikën 2.

Mangësia 2; - OE Power Engineering SHPK ka dorëzuar sigurimin e tenderit por i njëjti është i përbashkët për të dyja Lot-et. Bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit, bazuar në interpretimin e KRPP-së si dhe bazuar edhe në nenin 57 të LPP-së dhe 28 të RRPP-001/2022, ky sigurim nuk mund të konsiderohet i pranueshëm ashtu siç ka vepruar edhe OSHP në shumë raste të mëhershme andaj gabimi i tillë tenderuesin në fjalë e bënë të papërgjegjshëm. Për më shumë detaje referoju pikës 3 ku është përshkruar shkelja e nenit 57 të LPP-së.

Mangësia 3; - OE Power Engineering SHPK ka dorëzuar listën e çmimeve e cila çmimin total e ka të ndryshëm me çmimin total të paraqitur në formularin e tenderit. Neni 44.10 i RRPP-së e thotë shumë qartë:

40.10 Tenderuesi do të informohet me shkrim menjëherë për korrigjime të tilla. Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga AK në këtë mënyrë:

- a. Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është fituar duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total do të korrigjohet;
- b. Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet.

Tani në vazhdim po e paraqesin formularin e tenderit dhe listën e çmimit nga ku shihet dallimi dhe ndryshimi në çmimin e tillë.

FORMULARI I TENDERIT:

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

2 Rehabilitimi i instalimit të ndriçimit dhe prizave elektrike në Puntorinë mekanike LOT2

3. Çmimi total i tenderit është:

41,006.46 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **90** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

LISTA E ÇMIMEVE:

22	Signuresë automatike tip A ose tip B; 16A; 220V me punë	copë	24	10.00	240.00
23	Signuresë automatike tip A ose tip B; 50A; 220V me punë	copë	12	10.00	120.00
24	Aksesore per fiksime dhe palosje e kabllave sipas standardeve me mberthyes ose ne kanale te plastikes (me pune)	Pushall	1	500.00	500.00
				Gjithsejt cmimi total pa TVSH	34,747.00
				TVSH-ja	6,254.46
				Gjithsejt cmimi total me TVSH	41,001.46

Ky dallim në çmim TEK dy dokumentet më të rëndësishme të tenderit, e bënë tenderuesin e papërgjegjshëm ndërsa AK-në shklese të plotë të nenit 59 të LPP-së dhe 40.10 të RRPP-së.

Mangësia 4; - OE Power Engineering SHPK ka dorëzuar listën e çmimeve por e njëjta nuk është e plotësuar si duhet e as e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Formularët e tenderit janë dokumente që përgatiten nga AK ndërsa OE janë të detyruar të i plotësojnë ato duke u përgjigjur në të gjitha kërkesat e formularit në fjalë. Në rastin tonë edhe pse AK ka kërkuar që në fund të formularit përkatësisht Listës e çmimeve të shënohet emri i OE, emri dhe mbiemri i përfaqësuesit të OE, data e plotësimit, nënshkrimi dhe vula e OE, tenderuesi në fjalë asnjëherë nga këto nuk i ka ofruar. Bazuar në kërkesën e ligjit dhe të rregullores së prokurimit publik, në rastet e tilla tenderuesi konsiderohet se nuk e ka plotësuar formularin në fjalë si duhet dhe rrjedhimisht kjo e bënë të papërgjegjshëm. Përpos kësaj ky mos aplikim

i ligjit ashtu si duhet, AK-në e bënë shkelëse të plotë të nenit 59 të LPP-së dhe nenit 44 të RPPP-001/2022. Ja dëshmia:

27	22	Siguresë automatike tip A ose tip B; 16A; 220V me punë	copë	24	10.00	240.00	
28	23	Siguresë automatike tip A ose tip B; 50A; 220V me punë	copë	12	10.00	120.00	
29	24	Aksesore per fiksime dhe palosje e kabllave sipas standardeve me mberthyes ose ne kanale te plastikes (me pune)	Pushall	1	500.00	500.00	
30					Gjithsejt cmimi total pa TVSH	34.747.00	
31					TVSH-ja	6.254.46	
32					Gjithsejt cmimi total me TVSH	41.001.46	
33							
34							
35							
36							
37							
38		Emri i OE: (shëno emrin e OE ose te konzorciumit):					
39		Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit të OE:					
40			Nënshkrimi:				
41			Vendi dhe data:				
42			Vula e operatorit ekonomik / konzorciumit:				
43							

Mangësia 5; - OE Power Engineering SHPK ka dorëzuar disa ISO certifikata për prodhuesit nga të cilët pretendon që ka ofertuar materialin e kërkuar por pas një kontrolli të detajuar del që disa nga këto certifikata nuk janë të rregullta pasi që janë të pa afatshme për qëllimin e ofruar. Përpos kësaj edhe nuk ka të dhëna të mjaftueshme se të gjitha produktet e ofruar mbulohen me ISO certifikata andaj konsideroj se tenderuesi në fjalë ka dështuar ta plotësoj këtë kërkesë të AK-së dhe njëherit di duhej konsideruar i papërgjegjshëm. Ja dëshmia.. Ja dëshmia:

Has been assessed and found to be in accordance with the requirements of standard detailed below



ISO 9001:2015


Scope
The Manufacture of LED Light.

Certificate No.: ARES/CN/G1801050Q Certificate Renewal Date: 2020-08-14
Certificate Issue Date: 2018-02-02 Registration Expiration Date: 2021-02-01

The time interval between each surveillance audit and the last on-site audit shall not exceed 12 months, and the organization must obtain "surveillance audit approval notification" issued by ARES to ensure the validity of the certificate.

Authorized by :
Chion Power



Mungesa e kompletuar e ISO certifikatave tregon se kriteri nuk mund të konsiderohet i plotësuar ndërsa OE realisht do duhej cilësohej si tenderues i papërgjegjshëm.

Mangësia 6; - OE Power Enginerring SHPK ka dorëzuar disa katalogje por disa nga to nuk japin informatat e duhura, disa nuk mundën as të lexohen ndërsa nënvizimi i artikujve nëpër

katalogje nuk është bërë fare. Ne po ia bashkëngjisim ankesës vetëm një katalog sa për informim ndërsa të tjerët i gjeni tek tenderi i OE në fjalë ku gjendja e njëjtë është pothuajse tek shumica e katalogjeve të dorëzuara e që si të tilla e bëjnë të papërgjegjshëm OE në fjalë.

Vlen të thuhet edhe kjo se AK gjatë përgatitjes së refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, nuk i ka trajtuar aspak pretendimet tona ashtu si duhet, nuk ka mundur asnjë pretendim ta refuzoj me fakte e as me argumente por komplet përgjigjja është një tentim për manipulim dhe një filozofi çorientuese nga e cila mundohet të përfitoj dhe ta lë në fuqi vendimin e pa drejtë që e ka marrë në përzgjedhje të fituesit. Kjo përpos që konsiderohet shkelje e nenit 108/A të LPP-së, konsiderohet edhe një lloj tentimi për mashtrim dhe vendosje në lajthitje fillimisht neve e më pas edhe instancat që do e trajtojnë veprimin e tyre më pas.

Bazuar në krejt këtë, shihet se i OE të shpallur fitues ka pasur shumë mangësi që tregojnë qartë se nuk është i përgjegjshëm ndërsa veprimi i AK-së konsiderohet shkelje e plotë e ligjit dhe aplikim selektiv i kërkesave të dosjes së tenderit, që konsiston me shkelje të plotë të nenit 59 të LPP-së për favorizim të hapur të tenderuesit në fjalë.

5. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me nevojat veta sipas nenit 69.2.4 dhe 69.2.5 të LPP-së. AK ka vendosur vet kërkesa teknike që lidheshin me nenin 69 të LPP-së por që gjatë vlerësimit nuk i ka zbatuar si duhet. Kërkesat për përshtatshmërinë teknike si dhe për përshtatshmërinë profesionale që janë kërkuar nga vet AK shihet se janë keq aplikuar dhe anashkaluar plotësisht kur e ka vlersuar tenderin e OE që më pas pa asnjë të drejtë ligjore e ka shpallur fitues. Vlen të thuhet edhe kjo se asnjë produkt nuk është nënvizuar në katalog edhe përkundër që kjo ishte kërkesë decidive e dosjes së tenderit.

Këtu përpos që kemi të bëjmë me mos aplikim të drejtë të kriterëve të dosjes, aneksit 1 dhe kërkesave të nenit 69 të LPP-së të përcaktuara tek kërkesat e FDT-së dhe tek specifikim teknik, kemi të bëjmë edhe me favorizim të një OE të papërgjegjshëm.

Nisur nga gjendja faktike dhe nisur edhe nga ato që u thanë me lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

V E N D I M

APROHOHET si e bazuar ankesa e OE “**BAK - ING SH.P.K.**” lidhur me tenderin **Rehabilitimi i instalimit të ndriçimit dhe prizave elektrike në stacionin e mazutit dhe punëtorinë mekanike – Lot 2** i iniciuar nga **KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së për Lot 2 nga **KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.** dhe lënda të kthehet në **ri-vlerësim.**

Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht duke u bazuar në dispozitat ligjore të LPP-së, kërkesat e dosjes së tenderit e sidomos ato të specifikimit teknik, që realisht më pas do duhej që **FITUES** të shpallej OE “**BAK - ING SH.P.K.**”.















9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për tenderim dhe kontratë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

-  1 Njoftim per Kontrat
-  2 Dosja e Tenderit - Shqip
-  3 Pershkrimi cmimeve - Shqip - LOT1
-  4 Pershkrimi cmimeve - Shqip - LOT2
-  5 Specifikimi teknik - Shqip
-  6 Raporti i hapjes
-  7 Vendimi i AK
-  8 KERKESE PER RISHQYRTIM - KEK - BAK ING SHPK 25.05.2026
-  9 Pergjigje ndaj kerkeses per rishqyrtim - E pa bazuar
-  Formulari i tenderit - Power Engineering
-  ISO - Power Engineering
-  Pershkrimi cmimeve - Shqip - LOT2 - Power Engineering
-  Pozicionet 14,16,24,27,28 dhe 30 -1 - Power Engineering
-  Sigurimi i tenderit - Power Engineering

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*